



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna Dragash / Opština Dragaš / Dragas Municipality



Kryesuesi i KK-së  
01 Nr.060/0011002  
Dt. 14.07.2020  
Dragash

## THIRRIJE

Në bazë të Kërkesës së një numri të delegatëve të Kuvendit të Komunës së Dragashit, në harmoni me nenin 44.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenin 38.2 të Statutit të Komunës së Dragashit, për dt. 21.07.2020 ( e martë), duke filluar në ora 10,00, në sallën e Kuvendit Komunal- Dragash, KONVOKOJ seancën e VII-të (shtatë - të jashtëzakonshme) të Kuvendit Komunal të Dragashit, me këtë:

### *R e n d   d i t e*

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Deklaratës...

Shtojcë: 1. Kërkesa e Delegatëve të Kuvendit të Komunës  
2. Deklarata...










Me respekt !

KUVENDI KOMUNAL DRAGASH  
Kryesuesi  
Betim Merdiu, d.v.

Në bazë të nenit 44.1 të Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), nenit 44.1 të statutit të Komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, ne Delegatët e poshtëshënuar kërkojmë nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Dragashit që të caktoj seancë të jashtëzakonshme me një pikë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Deklaratës

REPUBLIKA E KOSOVES  
 Komuna e Dragashit  
 14. 7. 2008  
 01 060/1-11002

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi
1	GRANIT RIFAJ	
2	SHPETIM HAJREDINI	
3	Vexhat Juh	
4	SEVIM AVDUKALIC	
5	ARTAN LOSHAJ	
6	Xhemile Misinaj	
7	FELIQA GULEJMAMI	
8	Guada Bajrami	
9	ZAM HAJREDINI	
10		
11		
12		
13		



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Komuna Dragash / Opština Dragaš / Dragas Municipality**

01 Nr. \_\_\_\_\_

Dt. \_\_\_\_\_

**Dragash**

Në bazë të Nenit 4 dhe nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, të Ligjit për Vetëqeverisjen Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë nr. 28 / 04 qershor 2008), Nenit 32 të Statutit të Komunës së Dragash-it Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës së Dragash-it, në seancën e 7 (shtatë) të jashtëzakonshme të mbajtur më datë \_\_\_\_\_, miraton këtë:

*(Draft)*

## D E K L A R A T Ë

1. Konfirmojmë qëndrimin tonë dhe bindjen e paluhatshme se lufta mbrojtëse e qytetarëve të Kosovës, e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, dhe e përkrahur nga forcat e NATO-së, ishte luftë e drejtë dhe e pastër për çlirimin e Kosovës kundër regjimit gjenocidal të Slllobodan Millosheviqit, forcave ushtarake, policore e paramilitare të Serbisë në Kosovë.
2. Vlerësojmë të paprecedent veprimin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar për të publikuar njoftimin për një aktakuzë të pakonfirmuar nga Gjyqtari i procedurës paraprake ndaj dy prej liderëve kryesorë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, z.Hashim Thaçi dhe z. Kadri Veseli.
3. Shprehim shqetësimin se ky veprim i Zyrës së Prokurorit të Specializuar përbën edhe shkelje të të drejtave të njeriut, si dhe është në kundërshtim të plotë me parimin themelor të drejtësisë, atë të prezumimit të pafajësisë.
4. Ritheksojmë se lufta mbrojtëse e UÇK-së ka qenë e drejtë dhe do të mbetet përherë e tillë. Ajo nuk mund të njolloset asnjëherë. Bashkësia ndërkombëtare duhet ta çmojë lart bashkëpunimin e institucioneve kosovare dhe ish-pjesëtarëve të UÇK-së me institucionet e drejtësisë ndërkombëtare

- përgjatë këtyre njëzet vjetëve, përfshirë Dhomat e Specializuara. Në gjithë këto procese është dëshmuar pastërtia e luftës së popullit shqiptar për liri e pavarësi.
5. Njohim dhe vlerësojmë lart sakrificën, angazhimin dhe kontributin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të mbështetur nga NATO, e të udhëhequr nga SHBA-të dhe aleatet e saj, për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Solidarizohemi dhe shprehim njëzëri mbështetjen e plotë për z. Hashim Thaçi dhe z. Kadri Veseli, të cilët janë ndër themeluesit dhe udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe shprehim besimin e palëkundur për pafajësinë e tyre.
6. I konsiderojmë përpjekje të padrejta dhe të rrezikshme, por të perealizueshme, tendencat për ta kriminalizuar luftën e drejtë dhe të lavdishme të popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi. Refuzojmë çfarëdo përpjekje për ta etiketuar UÇK-në si agresore;
7. E vërteta për historinë e popullit shqiptar nuk mund të deformohet dhe as të tjetërsohet nga ata që pretendojnë për t'i barazuar viktimat me kryesit e krimeve serbe. Kosovën nuk mund ta dobësojë askush dhe të ardhmen e saj euroatlantike nuk mund ta devijojë dhe as ta ndalë asnjë përpjekje.
8. Si përfaqësues të qytetarëve, të zgjedhur në mënyrë demokratike, bëjmë thirrje për unitet mes njerëzve dhe bashkërendim të angazhimeve ndërmjet partive politike për të ruajtur shtetin e Kosovës, vlerat e luftës dhe pastërtinë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Betim Merdiu**

---